

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të drejtorive shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) dhe në bazë të nenit 25 paragrafit 2 dhe paragrafit 5 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 103/08, 33/2010, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12 dhe 24/13), si dhe në bazë nenit 6 dhe nenit 7, paragrafit 1, alinesë 4 të Ligjit të Byrosë së zhvillimit të arsimit („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13), ministri i Arsimit dhe Shkencës e vërtetoi Programin mësimor për matematikë për klasën e dytë të arsimit fillor nëntëvjeçar.

Cambridge International Examination
Byroja e zhvillimit të arsimit

PROGRAMI MËSIMOR

MATEMATIKA

për klasë të dytë

për arsimin fillor nëntëvjeçar

Shkup, shkurt 2014

Hyrja

Programi mësimor për matematikë për klasën e dytë e arsimit fillor nëntëvjeçar është marrë prej Qendrës ndërkombëtare për programe mësimore (Cambridge International Examination) dhe e përshtatur nga Byroja për zhvillimin e arsimit.

Miratimi i përshtatjes së programit mësimor është lejuar nga ekspertë të Qendrës ndërkombëtare për programe mësimore (Cambridge International Examination).

Programi mësimor përmban përmbledhje të qëllimeve mësimore zhvillimore të lëndës mësimore të matematikës. Në ato në mënyrë të detajuar përshkruhet çka nxënësi duhet të di ose çka duhet të mundet të bëjë në çdo vit të arsimit fillor.

Qëllimet mësimore sigurojnë strukturë për mësimdhënie dhe të mësuarit si dhe udhëzime për atë se cilat shkathtësi dhe dituri të nxënësit mund të vërtetohen.

Programi mësimor për matematikë është i ndarë në pesë fusha(lëmi): Numrat/Operacionet matematikore, Gjeometri, Matje, Punë me të dhëna dhe zgjidhje të problemeve. Katër fushat e para janë të mbuluara (përfshirë) në fushën Zgjidhje të problemeve, në të cilën janë të përshkruara teknikat, shkathtësitë dhe zbatimi i diturive si dhe strategjitë në zgjidhjen e problemeve. Strategjitë e të menduarit, gjithashtu janë pjesë kryesore në fushën(lëmin) Numrat. Ky program mësimor fokusohet në parime (principe) skema, sisteme, funksione dhe relacione ashtu që nxënësit të mund ti zbatojnë dituritë matematikore dhe të zhvillojnë të kuptuarit holistik për lëndën.

Programi mësimor për matematikë për klasën e dytë në arsimin fillor na jep bazë të theksuar (solide) nga e cila mund të përsosen (zhvillohen) fazat e mëtutjeshme të arsimit.

Programi mësimor realizohet me fond prej 5 orë në javë, gjegjësisht 180 orë në vit.

Programi mësimor i Kembrixhit është ndërtuar në bazë të vlerave të Kembrixhit dhe praktikës më të mirë nëpër shkolla. Ai është i përkushtuar kah qëllimi që të zhvillohen nxënës që do të bëhen të përgjegjshëm, inovativ dhe të angazhuar në një mësim aktiv dhe kreativ.

Pjesët e programit që kanë të bëjnë me notimin, kushtet hapësinore për realizimin e mësimit dhe normativit për kuadër arsimor janë dhënë në përputhje me nenin 25, paragrafit 5 të Ligjit për arsim fillor.

Programi mësimor për klasë të dytë

1. Fusha programore dhe rezultatet e pritura

Numri

Numra dhe sistem numrash

- Numëron, lexon dhe shkruan së paku deri në 100 dhe mbrapsht.
- Numëron deri 100 objekte, si psh., varg me monistra (topa).
- Numëron nga një dhe nga dhjetë numra njëshifrorë dhe dyshifrorë para dhe mbrapsht.
- Numëron nga dy, nga pesë dhe nga dhjetë dhe shfrytëzon grupime nga dy, nga pesë dhe nga dhjetë që të numëroj grup me numër më të madh objektiv deri 100.
- Fillon të numërojë me hapa të vogla përhershme, nga tre deri në 30 si dhe nga katër deri në 40, si psh. , 3, 6, 9,...27, 30 dhe 4, 8, 12,...36, 40.
- Diçka përfaqëson secila shifër në numrin dyshifror dhe i zërthen në dhjetëshe dhe njëshe.
- Përcakton numër që është për 1 ose për 10 më i madh ose më i vogël nga ndonjë numër dyshifror.
- Rrumbullakon numra dyshifrorë deri te dhjetëshja më e afërt.
- Tregon numra ndërmjet dy dhjetësheve të plota, si psh., numra ndërmjet 40 dhe 50.
- Vendos numër dyshifror në vargun numerik në të cilin janë shënuar dhjetëshet e plota.
- Dallon dhe shfrytëzon numra rendor më së paku deri te numri i dhjetë dhe më shumë.
- Radhit numra deri 100; krahason dy numra duke i shfrytëzuar shenjat „>“ dhe „<“
- Bën vlerësim të arsyeshëm deri 100 objekte, si psh., duke zgjedhur nga 10, 20, 50 ose 100.
- Kupton cilët numra janë çift dhe cilët tek dhe i dallon deri 20.
- Radhit numra, si psh. , çift/ tek të cilët fitohen me numërim nga 2, nga 5 dhe nga 10.
- Dallon se një gjysmë shkruhet $\frac{1}{2}$, një çerek(një e katërta) $\frac{1}{4}$ dhe tre të katërtat $\frac{3}{4}$.
- Dallon se cilat forma ndahen në gjysma dhe të katërtën dhe cilat jo.
- Gjen gjysma dhe të katërtën nga forma dhe nga grup i vogël objektiv deri 20.
- Dallon se $\frac{2}{2}$ ose $\frac{4}{4}$ bëjnë një të plotë dhe $\frac{1}{2}$ dhe $\frac{2}{4}$ janë të njëjta.

Operacione matematikore

Strategji të të menduarit

- I di të gjitha çiftet e numrave shuma e të cilëve është 10 dhe çiftet e numrave shuma e të cilëve është 20.
- I zbërthen të gjithë numrat deri 20 në çifte numrash dhe i shënon faktet adekuate (përkatëse) për mbledhje dhe zbritje.
- I gjen të gjitha çiftet prej dhjetësheve shuma e të cilave është 100 dhe i shënon faktet adekuate për mbledhje dhe zbritje, si psh., $30+70=100$ dhe $100-70=30$.
- I mëson dhe i dallon numrat që fitohen me numërim nga 2, nga 5 dhe nga 10 dhe i shqyrton faktet adekuate për pjesëtim.
- I dallon dhe i mëson vlerat e dyfishta të të gjithë numrave deri në 10, si dhe numrat 15, 20, 25 dhe 50.

Mbledhje dhe zbritje

- E ndërlihdh numërimin para/ mbrapsht nga 10 për të gjetur numër që është për 10 më i madh/vogël nga çdo lloj numri dyshifror dhe pastaj mbledh dhe zbret numër dyshifror me dhjetëshe të plota, si psh. $75 - 30$.
- E shfrytëzon shenjën „ = “ për të treguar se janë të barabartë (të njëjtë), si psh. $16 + 4 = 17 + 3$.
- Mbledh katër ose pesë numra më të vegjël.
- E dallon zbatimin e simboleve si \triangle , \square për të paraqitur numra të panjohur, si psh. $\triangle + \square = 10$
- Zgjedh barazime, si psh., $27 + \triangle = 30$.
- Mbledh/zbret numër njëshifror me/nga numër dyshifror.
- Mbledh çifte numrash me numra dyshifror.
- Gjen(zbulon) dallim të vogël ndërmjet çifteve të numrave dyshifrorë
- Kupton se mbledhja mund të bëhet sipas çfarëdo renditjeje, kurse zbritja jo.
- E kupton zbritjen si ndryshim dhe si zvogëlim.

Shumëzim dhe pjesëtim

- E kupton shumëzimin si mbledhje të mbledhësve të njëjtë dhe e përdor shenjën „ · “.
- E kupton shumëzimin si përshkrim të një vargu(rendi) numrash.
- E kupton pjesëtimin si grupim dhe e përdor shenjën „ : “.
- Përdor numërim nga dy, nga pesë dhe nga dhjetë për zgjidhje të problemeve praktike.
- I dyfishon numrat 5, 10, 15,...45, 50 dhe numrat e fituar i ndan (përgjysmon).
- Dyfishon numra dyshifror.
- Numëron nga 3 dhe 4, si hyrje në tabelën e shumëzimit dhe pjesëtimimit me 3 dhe 4.
- Di se gjatë pjesëtimimit mund të ketë mbetje.

Gjeometri

Forma dhe të menduarit gjeometrik

- Grupon, emëron, përshkruan, paramendon dhe vizaton forma 2D (si psh: katror, kundrejt, rreth, pesëkëndësh dhe gjashtëkëndësh të rregullt dhe jo të rregullt) sipas vetive (karakteristikave) të tyre; njeh forma 2D në pozicione të ndryshme.
- Grupon, emëron, përshkruan, bën forma 3D (si psh: kub, kuadër, kon, cilindër, rreth dhe piramidë) sipas vetive të tyre; dallon forma 2D nga forma 3D.
- Gjen simetri në format 2D dhe e vizaton vijën simetrike.
- Gjen shembuj në format 2D dhe 3D dhe simetri në mjedisin që e rrethon..

Pozicioni dhe lëvizja

- Përcjell dhe jep udhëzime për pozicionin, drejtimin dhe lëvizjen.
- Njeh tërësinë (të plotën), gjysmën dhe rrotullimin një të katërt (një çerek) në drejtim të lëvizjes të shigjetave të orës dhe në drejtim të kundërt.
- Njeh se këndi i drejtë është rrotullim një çerekësh(sa një e katërta).

Matje

Paratë (të hollat)

- I dallon të gjithë monedhat dhe bankënotat.
- Përdor sistem për shënim të parave deri në 100 denarë.
- E përcakton shumën e monedhave dhe bankënotave të nevojshme për të paguar shumë e caktuar prej 100 denarësh dhe llogarit sa duhet ti kthehet.

Gjatësia, masa dhe vëllimi.

- Llogarit, mat dhe krahason gjatësi, masë dhe vëllim, duke zgjedhur dhe përdorur njësi përkatëse (adekuate) standarte dhe jostandarte dhe instrumente përkatëse për matje.
- Krahason gjatësitë, masën dhe vëllimin duke përdorur njësitë standarde: centimetër, metër, 100 gr, kilogram dhe litër.

Koha

- I di njësitë për kohën (sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji dhe viti)
- E di marrëdhënien ndërmjet njësive pasuese për kohën.
- E lexon kohën deri në gjysmë ore në orë digjitale dhe analoge.
- Mat kohëzgjatjen të disa veprimtarive duke përdorur sekonda dhe minuta.
- I di dhe i radhit ditët e javës dhe muajt e vitit.

Punë me të dhëna

Organizim, kategorizim dhe paraqitje e të dhënave.

- Përgjigjet në pyetje me mbledhje (grumbullim) dhe shënim të të dhënave në lista dhe tabela dhe në mënyrë figurative i paraqet në grafikone dhe piktograme për paraqitje të rezultateve.
- Përdor diagramin e Kerolit dhe Venit për renditje të numrave dhe objekteve duke përdorur një kriter; fillon të përdor dy kritere; e sqaron zgjedhjen duke përdorur gjuhë përkatëse, përfshirë edhe fjalën “ jo “.

Zgjidhja e problemeve

Përdorimi i teknikave dhe shkathtësive në zgjedhjen e problemeve matematikore

- Zgjedh dhe përdor strategji përkatëse mentale për llogaritje dhe e sqaron rrugën (mënyrën) se si erdhi deri te përgjigjja.
- Gojarisht e sqaron mënyrën e zgjidhjes dhe të menduarit.
- E përdor diturinë për zgjidhje të problemeve dhe enigmave (probleme më të vështira).
- I kupton detyrat e thjeshta tekstuale (në një ose në dy hapa të lehta), përcakton cilat operacione janë të nevojshme (mbledhje ose zbritje, shumëzim ose pjesëtim i thjeshtë) për zgjidhjen e tyre, dhe me ndihmë i paraqet përmes objekteve, me vizatime ose me grup numrash.
- Paramendon ndodhi për detyrë të dhënë ,duke përfshirë në atë kontekst e edhe paratë.
- E vërteton përgjigjen të një detyre me mbledhje të numrave në radhitje të ndryshme dhe duke përdorur strategji të ndryshme, psh:
35+19 me mbledhje të 35 dhe 20 dhe zbritje të 1, dhe me mbledhje të 30+10 dhe 5+9.
- E vërteton zbritjen duke përdorur mbledhjen
- E përshkruan dhe e vazhdon grupimin me mbledhje me dy, me tre, me katër dhe me pesë deri ne 30 ose më shumë.
- I dallon lidhjet e thjeshta mes numrave, psh: ky numër është dy here më i madh se...
- I dallon lidhjet e thjeshta mes formave, psh: këto forma të gjitha kanë...anë-faqe
- Bën vlerësim të arsyeshëm të përgjigjes së një detyre.
- Jep mendimin e vet nëse ndonjë përgjigje është e arsyeshme.

2. Qëllime konkrete, Veprimtaritë dhe mjete për punë

Temat e programit mësimor janë të dhëna me shembuj të veprimtarive nëpërmjet të cilave mund të arrihen, si dhe materialet e nevojshme për realizimin e tyre. Çdo temë realizohet gradualisht dhe zhvillohet në tre periudha (faza) gjatë vitit mësimor (1A,2A,3A, 1B,2B,3B, 1C,2C,3C) për shkak të qasjes spirale në planifikimin dhe realizimin e mësimit në matematikë. Qasja spirale mundëson në procesin e mësimit të fillohet me atë që nxënësit e dinë dhe gradualisht (hap pas hapi) të përsoset (zhvillohet) dhe zgjerohet dituria e nxënësve.

Periudha (Faza) 1	Periudha 2	Periudha 3
1A Numri dhe zgjidhje e problemeve	2A Numri dhe zgjidhje e problemeve	3A Numri dhe zgjidhje e problemeve
1B Gjemoetri dhe zgjidhja e problemeve	2B Punë me të dhëna dhe zgjidhje e problemeve	3B Gjemoetri dhe zgjidhja e problemeve
1C Matje dhe zgjidhje e problemeve	2C Matje dhe zgjidhje e problemeve	3C Matje dhe zgjidhje e problemeve

1A. Numri dhe zgjidhja e problemeve

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Numrat dhe sistem numrash</p> <p>Nxënësi/nxënësja numëron, lexon dhe shkruan më së paku deri te numri 100 edhe mbrapsht (anasjelltas).</p>	<p>Cili është numri im? Të mbulohen disa numra në tabelën „qindëshe”. Cili numër është fshehur (mbuluar)? Si e dini?</p>	<p>Tabela „qindëshe” prerje nga letra</p>	<p>Përdorni (shfrytëzoni) prerje të thjeshta, si dhe prerje të gatshme që të mbuloni më shumë numra sipas radhitjeje të ndryshme.</p>
<p>Numëron deri 100 objekte, si psh.: varg me monistra (topa)</p>	<p>Vendosni disa objekte në tavolinë, gruponi për ta lehtësuar numërimin. Sa objekte ka në tavolinë?</p>	<p>Deri 100 objekte të vogla</p>	<p>Përdorni (shfrytëzoni) katrorë në tavolinë për disa nxënës.</p>
<p>Numëron nga dy, pesë dhe dhjetë dhe përdor grupimin për dy, për pesë dhe për dhjetë për të numëruar numër më të madh të objekteve deri 100.</p>	<p>Përdorim të modelit (varg) për numërim dhe grupim.</p>	<p>Tabela „ qindëshe”</p>	
<p>Numëron nga një dhe nga dhjetë numra një shifrorë dhe dyshifrorë para dhe mbrapsht.</p>	<p>Numërim nga e gjithë paralelja.</p>	<p>Tabela „ qindëshe”</p>	
<p>Përcakton numrin që është për 1 ose për 10 më i madh ose më i vogël nga ndonjë numër dyshifror.</p>	<p>Numërim nga e gjithë paralelja dhe numërim grupor.</p>	<p>Tabela „qindëshe”</p>	
<p>Rrumbullakon numra dyshifrorë deri te dhjetëshja më e afërt.</p>	<p>Numërim nga e gjithë paralelja dhe numërim grupor.</p>	<p>Tabela „qindëshe”</p>	

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe material)	Komente
<p>Tregon numra ndërmjet dy dhjetësheve të plota si psh: numra ndërmjet 40 dhe 50</p> <p>Vendos numër dyshifror në vargun numerik në të cilin janë vendosur dhjetëshet e plota.</p> <p>Njeh dhe përdor numra rendor më së paku deri në numrin e dhjetë dhe më shumë</p> <p>Kupton cilat numra janë çift, cilët numra janë tek dhe i njeh (dallon) deri në 20</p> <p>Llogaritje I njeh të gjithë çiftet e numrave shuma e të cilëve është 10 dhe çifte numrash shuma e të cilëve është 20.</p> <p>I zbërthen të gjithë numrat deri në 20 në çifte dhe i shënon faktet përkatëse për mbledhje dhe zbritje.</p>	<p>Lojë për grup më të vogël</p> <p>Aktivitet për të gjithë paralelen, grup më të vogël ose çift.</p> <p>Aktivitet për vendosje të numrave për të gjithë paralelen grup më të vogël ose çift.</p> <p>Lojë për të gjithë paralelen: Cili është numri im?</p> <p>Gjeni çift numrash në letra të cilët janë të njëjtë me 10/20</p> <p>Modelim nga arsimtari, çiftet luajnë lojë: me radhë zgjedhin letër (psh.12) dhe shkruajnë fakte të lidhura me mbledhje dhe zbritje.</p>	<p>Letra me numra me dhjetëshe të plota, tabela “qindëshe”.</p> <p>Letra me numra dyshifror, varg me numra me dhjetëshe të plota.</p> <p>Letra me numra 1-10 (dhe më shumë), varg numrash i pashënuar.</p> <p>Letra me numra deri ne 20.</p> <p>Letra me çift numrash gjithsej 10/20.</p> <p>Komplet letrash me numra, një komplet për një çift nxënësish. Kube që kanë lidhshmëri mes tyre.</p>	

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe material)	Komente
<p>I gjen të gjithë çiftet e dhjetësheve shuma e të cilave është 100 dhe i shkruan faktet përkatëse për mbledhje dhe zbritje si psh: $30+70=100$ dhe $100-70=30$</p> <p>I mëson dhe i dallon numrat që fitohen duke numëruar me 2, me 5, me 10 dhe i shqyrton faktet përkatëse për pjesëtim.</p>	<p>Propozim nga arsimtari çiftet luajnë lojë: me radhë zgjedhin letër (psh. 40), dhe e gjejnë dhjetëshen e plotë e cila e mbledhur me numrin e zgjedhur jep 100.</p> <p>Arsimtari propozon lojë; nxënësit luajnë në çift. Hidhet kubi i shënuar me 2, 2, 5, 5, 10, 10. Nxënësi vazhdon të numërojë nga 2, nga 5 dhe nga 10 varësisht nga numri që ka rënë.</p> <p>Numrat e treguar mbulohen në tabelën „qindëshe”.</p>	<p>Komplet letrash me numra të cilat janë dhjetëshe të plota në çift, tabela „qindëshe”, kube që kanë lidhshmëri mes tyre.</p> <p>Tabelë „qindëshe” dhe kub i shënuar nga një për çdo çift nxënësish, llogaritëse (zheton) ose kube.</p>	

Objektivat e mësimnxënies	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Mbledhje dhe zbritje Mbledh katër ose pesë numra më të vegjël.</p> <p>E përdor shenjën “ = “ për të treguar njëllojshmëri (se janë të njëjtë), psh $16+4=17+3$</p> <p>Mbledh/zbret numër njëshifror me /nga numri dyshifror.</p> <p>Kupton se mbledhja mund të bëhet në çfarëdo lloj radhitjeje, ndërsa zbritja jo.</p> <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <p>E kupton shumëzimin si mbledhje të mbledhësve të njëjtë dhe e shfrytëzon shenjën “ . “</p> <p>E kupton shumëzimin si përshkrim të një vargu numrash.</p>	<p>.</p> <p>Hidhni 4 ose 5 herë kubin 1-6. Shkruani numrat dhe mblidhni.</p> <p>Dy herë hidhni kubin, shkruani numrat dhe mblidhni ato. Përdorni shenjën = mandej shënoni përgjigjen.</p> <p>Formoni numër dyshifror me dy letra të tërhequra. Pastaj mblidhni/zbrisni numrin e parë.</p> <p>Vendosni letra me numra me fytyrë teposhtë (mbrapsht). Ktheni dy cilat do nga ato. Shënoni të dy shumat. Proveni çka ndodh sikur të jetë zbritje me numrat e tërhequr.</p> <p>5 mbledhur 3 herë bashkë është $5+5+5$ ose 3 kupe me nga 5 ose 3</p>	<p>Kube të mjaftueshme për çdo nxënës.</p> <p>Kube të mjaftueshme për çdo nxënës.</p> <p>Letra me shifra 0-9, tabela “qindëshe”, varg numerik.</p> <p>Letra me shifra 0-9, llogaritës (zheton) ose kube.</p> <p>Llogaritëse (zheton), kube.</p>	

Objektivat e mësimnxënies	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Zgjidhje e problemeve</p> <p>Zgjedh dhe përdor strategji mentale të përkatëse për llogaritje dhe e sqaron mënyrën se si erdhi deri te përgjigjja.</p> <p>Gojarisht e sqaron mënyrën e zgjidhjes dhe mendimin.</p> <p>Përdor diturinë për zgjidhje të problemeve dhe enigmave (problem më të vështirë).</p> <p>I kupton detyrat e thjeshta tekstuale (me një ose dy hapa), përcakton cilat operacione janë të nevojshme (mbledhje ose zbritje, shumëzim ose pjesëtim i thjeshtë) për zgjidhjen e tyre dhe me ndihmë i paraqet me objekte, me vizatime ose me vargje numrash.</p> <p>Paramendon ngjarje për detyrën e dhënë, duke përfshirë në atë kontekst edhe paratë.</p> <p>E vërteton përgjigjen e një detyre me mbledhje të numrave me radhitje të ndryshme dhe duke përdorur strategji të ndryshme si psh: 35 +19 me mbledhje të 35 dhe 20 dhe zbritje të 1, dhe mbledhje të 30+10</p>	<p>Nxënësit mendojnë dhe gojarisht përgjigjen në detyrën e parashtruar nga arsimtari: Ka pasur 11 mollë në një thes. Unë hëngra 3.</p> <p>Çdo nxënës ose grup sqaron si e kanë zgjedhur detyrën.</p> <p>Duke përdorur 3 kube, hulumtoni sa shuma të ndryshme gjithsej mund të fitohen.</p> <p>Paramendoj (mendoj) numër dhe mandej e ndaj në gjysmë. Përgjigjja është 8, cilin numër e mendova? Arsimtari demonstroi, nxënësit paramendojnë problem të tyre.</p> <p>Shkruani një barazim me mbledhje ose zbritje. Çdo grup paramendon ndodhi për barazimin e dhënë.</p> <p>Hyrje për të gjithë paralelen, punë individuale e nxënësve në detyra me mbledhje. Nxënësit sqarojnë cilën strategji e kanë përdorur gjatë mbledhjes.</p>	<p>Të përdoret përgatitje praktike e cila do ti përshtatet situatës (kontekstit).</p> <p>Kub (1-6 ose 0-5).</p> <p>Përgatitje praktike e kapshme për ato të cilët kanë nevojë për të njëjtën.</p> <p>Përgatitje praktike e kapshme për ato të cilët kanë nevojë për të njëjtën.</p> <p>Përgatitje praktike e kapshme për ato të cilët kanë nevojë për të njëjtën.</p>	<p>Ashtu si nxënësit kalojnë gjatë problemeve, mund të përdoret instrument për vëzhgim për vlerësimin e tyre.</p>

dhe 5+9. E vërteton zbritjen duke përdorur mbledhjen.	Hyrje për të gjithë paralelen, punë individuale e nxënësve në detyra me mbledhje. Nxënësit sqarojnë cilën strategji e kanë përdorur gjatë zbritjes.		
--	---	--	--

1B: Gjeometri dhe zgjidhje e problemeve

Objektivat e mësimnxënies	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Gjeometri</p> <p>Grupon, emëron, përshkruan, mendon dhe vizaton forma 2D (psh: katror, kënddrejtë (drejtkëndësh), rreth, pesëkëndësh dhe gjashtëkëndësh të rregullt dhe të çrregullt) sipas vetive (karakteristikave) të tyre njëh: forma 2D në gjendje të ndryshme.</p> <p>Grupon, emëron, përshkruan, bën forma 3D (psh: kub, kuadër, kon, cilindër, top dhe piramidë) sipas vetive të tyre I dallon format 2D nga format 3D.</p> <p>Gjen simetrinë te format 2D dhe e vizaton vijën simetrike.</p> <p>Gjen shembuj me format 2D dhe 3D dhe simetri në mjedisin që e rrethon.</p>	<p>Përdorni fjalor matematikor për emërim, klasifikim dhe përshkrim të disa karakteristikave të 2D formave. Përdorni shembuj të formave 2D. Zgjidhni shembull me karakteristika të ngjashëm.</p> <p>Përdorni fjalor matematikor për emërim, klasifikim dhe përshkrim të disa karakteristikave të 3D formave. Përdorni shembuj të formave 3D. Zgjidhni shembull me karakteristika të ngjashëm</p> <p>Filloni të dalloni dhe shënoni vijën simetrike: përdorni pasqyra, njolla ngjyrash, pllaka panel, forma prej gume, kube që lidhen mes tyre. Vizatoni vijë simetrike në vizatime të përgatitura më pare.</p> <p>Gjeni këto në mësonjëtoje, shkollë dhe mjedisin që na rrethon.</p>	<p>2Dforma.</p> <p>3Dforma.</p> <p>Çfarëdo objekti mund të shfrytëzohet për të treguar shembuj të vijës simetrike.</p> <p>Letër, laps, kamerë, shembuj me forma.</p>	<p>Nxënësit të kuptojnë se cilado formë që ka thellësi ose lartësi është formë 3D. Nxënësit mund ti gjejnë format 2D si anë (faqe) të formave 3D.</p> <p>Përdorni kompletin për orë të tjera. Dizajnoni dhe bëni komplete të ndryshme në pjesë të ndryshme.</p>

Zgjidhje e problemeve Njeh raportet e thjeshta midis formave si psh: këto forma të gjitha kanë....faqe	Krahasoni dhe shënoni karakteristikat e kundërta të 2D dhe 3D formave.	2D dhe 3D forma.	
--	--	------------------	--

1C: Matje dhe zgjidhje e problemeve

Objektivat e mësimnxënies	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Matje Njeh (dallon) të gjitha monedhat dhe bankënotat.</p> <p>Përdor sistem për shënim parash deri 100 denarë.</p> <p>E përcakton shumën e monedhave dhe bankënotave të nevojshme për të paguar një shumë të caktuar prej 100 denarësh dhe e llogarit sa duhet ti kthehet.</p> <p>Llogarit, mat dhe krahason gjatësi, peshë dhe vëllim, duke zgjedhur dhe përdorur njësi përkatëse standarde dhe jostandarde dhe instrumente përkatëse për matje</p>	<p>I dallon dhe e di vlerën e të gjitha monedhave. Zëvendësim të monedhave me vlerë ekuivalente duke përdorur 2 ose 3 monedha më të vogla. Gjithsej monedha: Sa është vlera e tyre tani?</p> <p>Kupton, praktikon dhe fillon të lexoj vlerën e parave. Përputhje e vlerave të shënuara me paratë e vërteta.</p> <p>Mbledhje dhe zbritje përmendësh dhe përdorim të strategjive vetjake për zgjidhje të detyrave në kontekst të parave</p> <p>Përdor letra në të cilat janë të shënuara simbole me njësi standarde për gjatësinë dhe largësinë; peshën, vëllimin. Nxënësi parashikon: më gjatë ose më shkurtër se një metër, më rëndë ose më lehtë se një kilogram, çka përfshin më shumë ose më pak se një litër.</p>	<p>Monedha/bankënotë me vlera përkatëse.</p> <p>Të holla. Monedha/bankënota</p> <p>Monedha/bankënota përkatëse.</p> <p>Objekte, mjete, letra në të cilat janë të shënuar simbole me njësi standarde, letra për „më shumë se” ose „më pak se”.</p>	<p>Ka rëndësi të madhe për këtë të përdoren para reale (të vërteta) se sa „para jo të vërteta”.</p> <p>Gojarisht sqaroni metodat dhe rezymentet. Kjo mund të përdoret si instrument për vlerësim.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>I krahason gjatësitë, peshën dhe vëllimin duke përdorur njësi standarde: centimetër, metër, 100g, kilogram dhe litër.</p>	<p>.Përdorni njësi standarde dhe jostandarde për matje në raste të ndryshme. Psh më e gjatë/më e shkurtër, matje në metër/centimetër.</p> <p>Më e rëndë/më e lehtë baraspeshim ose matje. Mbulon pjesë më të madhe me mbushje dhe matje litër/mililitër.</p>	<p>Instrumente për matje</p>	<p>Përdorni vëzhgim për të gjitha veprimtarive praktike. Kjo mund të përdoret si instrument (vegël) për vlerësim.</p>
<p>I di njësitë për kohën (sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji dhe viti).</p> <p>E di raportin ndërmjet njësive vijuese për kohën.</p> <p>Lexon kohën deri në gjysmë ore në orë digjitale dhe analoge.</p> <p>E mat kohëzgjatjen të disa veprimtarive duke përdorur sekonda dhe minuta.</p> <p>I di dhe i radhit ditët e javës dhe muajt e vitit.</p>	<p>Të kuptuarit, të zbatuarit dhe fillim të leximit të kohës nga njësitë për kohën të mësuara në vitin paraprak dhe zgjerim i të njëjtave.</p> <p>Propozim për njësi përkatëse për kohën për të matur kalimin e kohës: sa kohë na nevojitet...? Çka zgjat rreth 20 sekonda? 1 minutë? 1 orë?</p> <p>Përshtatje me situata nga jeta reale në klasë dhe shtëpi.</p> <p>Psh: Sa gjatë zgjat....? Hidhu 3 herë, vrapo rreth palestrës, shkruaj emrin 10 herë etj.</p> <p>Radhitje e ditëve të javës, muajt e vitit dhe stinëve të vitit. Njohje e ditëve, periudhave të rëndësishme gjatë ditës ose vitit (ditëlindja).</p>	<p>Letra me fjalë.</p> <p>Orë rëre, kronometër, orë analoge me shigjetë të dytë, orë digjitale.</p> <p>Orë analoge dhe digjitale.</p> <p>Orë rëre, kronometër, orë analoge, orë digjitale.</p> <p>Letra me fjalë.</p>	

Objektivat e mësimnxënies	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Zgjidhje e problemeve</p> <p>Zgjedh dhe përdor strategji mentale përkatëse për llogaritje dhe e sqaron mënyrën si erdhi deri te përgjigjja.</p> <p>Gojarisht sqaron mënyrë e zgjidhjes dhe të menduarit.</p> <p>Përdor dituritë për zgjidhjen e problemeve dhe enigmave.</p> <p>Kupton detyrat e thjeshta tekstuale (me një ose dy hapa), përcakton cilat operacione janë të nevojshme (mbledhje ose zbritje, shumëzim ose pjesëtim i thjeshtë) për zgjidhje të tyre dhe me ndihmë i paraqet me objekte, me vizatime ose me varg numrash.</p>	<p>Koha: Hipa në autobus në ora 10. Udhëtimi zgjati gjysmë ore. Në sa ora arrita? Si e di? Si e fitove rezultatin?</p> <p>Këto Veprimtaritë mund ti përfshijnë edhe 3 qëllimet mësimore të ardhshme (vijuese).</p>	<p>Letër dhe laps për shënime.</p>	<p>Mendoni grup pyetjesh. Nxënësit mund të mendojnë pyetje për të tjerët.</p>
<p>Paramendon ndodhi për detyrën e dhënë duke përfshirë në atë kontekst edhe paratë.</p> <p>E vërteton përgjigjen e një detyre me</p>	<p>E kam këtë shumë parash, më është dhënë e njëjta shumë përsëri. Sa para kam tani? Një libër kushton dy here më shumë se një gazetë. Gazeta kushton... Sa kushton libri?</p> <p>Zgjidhje e problemeve si psh:</p>	<p>Të sigurohen monedha/bankënotë për ata të cilëve u nevojitet për kraheje më e madhe.</p> <p>Të sigurohen</p>	<p>Shkathësia e këtyre veprimtarive është në llojet e pyetjeve të cilat përdoren.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>mbledhje të numrave me radhitje të ndryshme dhe duke përdorur strategji të ndryshme si psh: 35+19 me mbledhje 35 dhe 20 dhe zbritje të 1, dhe me mbledhje 30+10 dhe 5+9.</p> <p>E vërteton zbritjen duke përdorur mbledhjen.</p> <p>Bën vlerësim të drejtë të përgjigjes të një pyetje.</p> <p>Jep mendim personal nëse ndonjë përgjigje është e arsyeshme.</p>	<p>Mund të përdorni tre monedha për të paguar gjëra të ndryshme (të cilat kanë çmime). Në sa mënyra të ndryshme mund ti përdorni monedhat tuaja për të fituar një shumë të caktuar? Kam 2 monedha me vlerë të njëjtë. Çfarë mund të kem gjithsej?</p>	<p>monedha/bankënota për ata të cilëve u nevojitet përkrahje më e madhe. Të ketë “bankë” për pyetje të përgatitura më pare.</p>	

2A: Numri dhe zgjidhja e problemeve

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse(mjete dhe materiale)	Komente
<p>Numrat dhe sistem numrash</p> <p>Numëron nga dy, nga pesë dhe nga dhjetë dhe përdor grupim me dy, me pesë dhe me dhjetë për të numëruar numër më të madh objektiv deri në 100.</p> <p>Numëron nga një dhe nga dhjetë numra njëshifrorë dhe dyshifrorë para dhe mbrapsht.</p> <p>Përdor numërimin me dy, me pesë dhe dhjetë për të zgjidhur problem praktike.</p> <p>I di të gjithë çiftet e numrave shuma e të cilëve është 10 dhe çiftet e numrave shuma e të cilëve është 20.</p>	<p>Numëron nga dy, nga pesë dhe nga dhjetë duke filluar prej zeros ose prej çfarëdo numri njëshifror deri në 100. Si psh., gjatë numërimit nga dy në tabelën „qindëshe” rrethojë secilin numër të dytë. Çka vëreni? Çka mund të thoni për numrat e rrethuar (numrat çift)? Çka mund të thoni për numrat e parrethuar (tek). Vendosi numër të caktuar zhetonësh (objekte të vogla) në bankë. Sa ka? Në fillim gruponi nga dy, pastaj nga pesë dhe nga dhjetë.</p> <p>Filloni prej cilitdo numër dhe vazhdoni me numërim të njësheve deri 100 dhe mbrapsht. Pastaj filloni me numër dyshifror dhe numëroni nga 10 deri 100 dhe mbrapsht.</p> <p>Filloni prej cilitdo numër dhe vazhdoni numërimin nga dy, nga pesë ose nga dhjetë, duke shfrytëzuar tabelën “qindëshe” ose varg numrash.</p> <p>Nxënësit i përsërisin dyshet e numrave shuma e të cilave është 10, kurse pastaj dyshet e numrave shuma e të cilave është 20, të gjithë bashkë dhe në grupe më të vogla.</p>	<p>Tabela „qindëshe” Varg numrash Zhetonë.</p> <p>Tabela “qindëshe” Varg numrash.</p> <p>Tabela “qindëshe” Kalkulator me funksion konstant.</p> <p>Tabelë “qindëshe”.</p>	<p>Disa nxënës të cilët duhet të punojnë me numra më të vegjël, ndoshta do të duan varg me numra.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Di çka përfaqëson çdo shifër te numri dyshifror dhe i zbërthen në dhjetëshe dhe njëshe.</p> <p>Radhit numra deri në 100; krahason dy numra duke përdorur relacionet (shenjat) `<` dhe `>`.</p> <p>Bën vlerësim të arsyeshëm deri në 100 objekte, p.sh., duke zgjedhur prej 10, 20, 50 ose 100.</p>	<p>E gjithë klasa e përsërit numërimin me 2, me 5 dhe me 10.</p> <p>Të kuptuarit, zbatimi dhe fillimi i leximit të numrave dyshifror me sqarimin e vlerës lokale. Të njohurit e zeros si udhëheqës i vendit njësheve tek numrat dyshifror tek dhjetëshet e plotat. Të kuptohet që 38 është 30+8. Çfarë përfaqëson shifra 6 te numri 26? Dhe çfarë te 68? Çfarë përfaqëson 9 te numrat 59 dhe 19?</p> <p>Lojë të qëlluarit: Cili numër është më i madh se numri ..? Cili numër është më i vogël se numri ..?</p> <p>Vendosjen e numrave në varg të zbrazët numrash.</p> <p>Futjen e relacioneve `<` dhe `>`.</p> <p>Organizohen situatë praktike në të cilat nxënësit e vlerësojnë numrin e objekteve: Sa sfera ka në kuti? Sa monedha ka në grumbullin? Sa topa ka në kuti? Sa yje ka në kartë? Të shkruarit e vlerësimeve të vargut të numrave, në vendet përkatëse</p>	<p>Vendosjen e letrave me vlerë (shigjetë).</p> <p>Tabela „qindëshe”.</p> <p>Varg i zbrazët për numra.</p> <p>Poster me relacione të shkruara `<` dhe `>`.</p> <p>Grumbull objektësh për vlerësim.</p> <p>Varg bosh për numra.</p> <p>Varg me numra.</p>	<p>Përsëritje tek tabela „qindëshe” nxënësve më pak të sigurt u mundëson të bashkohen me atë që ata e dinë dhe ta dëgjojnë atë që nuk e dinë.</p> <p>Nxënësit, gjithashtu, mund tu parashirojnë pyetje nxënësve të tjerë në klasë.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Radhit numra, p.sh.: çift/tek të cilët fitohen duke numëruar nga 2, nga 5 dhe nga 10.</p> <p>Strategji mendimi I dallon dhe i mëson vlerat e dyfishta të të gjithë numrave deri në 10, si edhe numrat 15, 20, 25 dhe 50.</p> <p>Mbledhje dhe zbritje Mbledh/zbret numër njëshifor me/nga numër dyshifror .</p> <p>E lidh numërimin prej fillimit/ dhe mbrapsht nga 10, që të gjejë numër i cili është më i madh/vogël nga cilido numër dyshifror, dhe pastaj mbledh dhe zbret numër dyshifror me dhjetëshe të plota, p.sh., 75-30.</p> <p>Mbledh dyshe të numrave dyshifor.</p>	<p>Arsimtari tregon numra në tabelën “qindëshe” dhe pyet : a është tek numri? Si e dini? A është çift numri? Si e dini? A është fituar duke numëruar nga 2, nga 5 dhe nga 10? Si e dini?</p> <p>Veprimtaritë praktike për gjetjen e vlerave të dyfishta të të gjithë numrave deri në 10. Nxënësit në klasë përsërisin për vlerën e dyfishtë të numrave deri në 10.</p> <p>Veprimtaritë praktike të numërimit prej fillimit (mbledhje) dhe numërimit mbrapsht (zbritje) duke përdorur tabelën “qindëshe” dhe vargun e numrave.</p> <p>Mbledhje dhe zbritje të numrave dyshifror me dhjetëshe të plota duke përdorur tabelën “qindëshe”.</p> <p>Zbërthimin e numrave dyshifror në dhjetëshe dhe njëshe dhe numrat e fituar përdoren për mbledhjen e dysheve të numrave dyshifror duke përdorur tabelën `njëqind`.</p>	<p>Tabela “qindëshe”.</p> <p>Objekte për numërim. Kalkulator.</p> <p>Tabela „qindëshe”. Varg i numrave Objekte për numërim.</p> <p>Tabela „qindëshe”.</p> <p>Tabela „qindëshe”.</p>	<p>Fillon të dallojë që rezultati përfundon me 0 kur shumëzuesi është 10; kur shumëzues është 5 rezultati përfundon me 0 ose 5; dhe kur shumëzues është 2 fitohen numra që mbarojnë me 0, 2, 4, 6, 8. Të shkruarit e fakteve për vlerat e dyfishta të numrave ashtu që të mund ti shohin të gjithë nxënësit. Sa më shumë nxënës e përdorin tabelën “qindëshe” aq më shpejtë do të mund të largohen nga praktika dhe tabela „qindëshe” do të bëhet fotografi mendore. Disa nxënësve do t’ju duhet kohë më e gjatë praktikisht të punojnë objekte, nga të tjerët.</p> <p>Imazhi vizual i vargjeve mund tu ndihmojë nxënësve në të kuptuarit e shumëzimit. Disa nxënës do të duhet ta shfrytëzojnë më gjatë se të tjerët.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe material)	Komente
<p>Përcakton dallim të vogël ndërmjet dysheve të numrave dyshifror.</p> <p>E kupton diferencën si ndryshim dhe si zvogëlim.</p> <p>Shumëzim dhe pjesëtim E kupton shumëzimin si përshkrim të vargut të numrave.</p> <p>E kupton pjesëtimin si grupim dhe e përdor shenjën '='.</p>	<p>Me shfrytëzimin e tabelës „qindëshe” nxënësit e zbatojnë strategjinë e të numëruarit mbrapsht duke nisur nga numri më i madh ose të numëruarit prej fillimit duke nisur nga numri më i vogël. Ofroni të dyja mundësitë.</p> <p>Nxënësit nisin ta kuptojnë ndryshimin si zvogëlim të vlerës së numrit. Shfrytëzimi i vargut të numrave për të zbuluar kur duhet të numërohet prej fillimit ose mbrapsht ose të kërkohet dallimi ndërmjet tyre.</p> <p>Nxënësit nisin të dallojnë si vargjet e numrave mundësojnë shumëzim sipas cilësdo radhitje. P.sh., 4 grumbuj prej 3 objektesh dhe 3 grumbuj prej 4 objektesh e japin të njëjtin rezultat.</p> <p>Të kuptuarit e operacionit pjesëtim si grupim ose ndryshim të vazhdueshëm. Shkruani shprehje numerike duke zbatuar shenjat '=' dhe '='.</p>	<p>Tabela „qindëshe”.</p> <p>Varg i numrave.</p> <p>Shembuj të vargjeve të ndryshme.</p> <p>Pajisje për njehsim.</p>	<p>Varësisht nga numrat e përdorur, ndonjëherë ka më shumë kuptim numërimi të bëhet duke u rritur sepse duke u zbritur.</p> <p>Imazhi vizual i vargjeve mund tu ndihmojë nxënësve në të kuptuarit e shumëzimit. Disa nxënës do të duhet ta shfrytëzojnë më gjatë se të tjerët.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Di që gjatë pjesëtimit mund të ketë mbetje.</p>	<p>Numëroni 10 objekte. Ndani në 2 grupe të barabarta. Sërish të kombinoni. Largoni disa objekte dhe ndani në dy grupe të barabarta. Çfarë ndodh? A ka mbetje? Përsëriteni disa herë ashtu që do të përfshihen të gjithë numrat nga 1 deri 10. Shkruani ato numra të cilët pjesëtohen pa mbetje dhe ato të cilët pjesëtohen me mbetje.</p> <p>Tentoni me numra më të mëdhenj. Çfarë ndodh? Shkruani ato numra të cilët kanë mbetje. A mund të parashikoni cilët numra do të kenë mbetje dhe cilët jo? Si e dini?</p>	<p>Objekte. Tabela „qindëshe”.</p>	
<p>Zgjidhje e problemeve Zgjedh dhe shfrytëzon strategji përkatëse mendimi për njehsim dhe e sqaron procedurën si ka arritur deri te përgjigjja.</p> <p>Gojarisht e sqaron metodën e zgjidhjes dhe mënyrën e të menduarit</p>	<p>Para çdo njehsimi pyetni nxënësit: Si do ta bëni këtë? Filloni me atë që nxënësit e dinë, që të zbuloni atë që nuk e dinë. Dhënia e mundësive nxënësve të zbulojnë dhe ndajnë strategji të tyre ndërmjet veti.</p> <p>Nxënësit zgjedhim dhe shfrytëzojnë operacione konkrete me numra dhe mënyra për njehsim që të zgjidhin situata problematike dhe detyra të ndryshme.</p>		

<p>E shfrytëzon diturinë për zgjidhjen e problemeve.</p> <p>I kupton detyrat e thjeshta tekstuale (në një apo në dy hapa të lehtë), përcakton cilët operacione janë të nevojshme (mbledhje ose zbritje, shumëzim i thjeshtë ose pjesëtim) për zgjidhjen e tyre dhe me ndihmë, i paraqet me objekte, me vizatime ose me varg numrash.</p> <p>Paramendon tekst për detyrën e parashtruar, duke i përfshirë në këtë kontekst edhe të hollat.</p> <p>E kontrollon përgjigjen e një detyre me mbledhjen e numrave në radhitje të ndryshme dhe me shfrytëzimin e strategjive të ndryshme, p.sh., $35+19$ me mbledhjen e 35 dhe 20 dhe zbritjen e 1, dhe me mbledhjen e $30+10$ dhe $5+9$.</p> <p>E kontrollon zbritjen duke shfrytëzuar mbledhjen.</p>	<p>Zgjidhje e detyra të thjeshta tekstuale me situatë nga "jeta reale". Shfrytëzoni strategji tuaja për zgjedhjen e operacionit përkatës. Gojarisht sqaroni metodat e arsyetimit. Çfarë do të ishte teksti për $18-12=6$?</p> <p>Për shembull teksti mund të jetë: Ka 18 sheqerka në një qese, unë hëngram 12, prandaj 6 janë sheqerka e mbetura.</p> <p>Jepni shumë shembuj për të gjithë 4 operacionet me numra.</p> <p>Kjo duhet të vlejë për të gjithë njehsimet.</p> <p>Kjo duhet të vlejë për të gjithë njehsimet.</p>		
---	---	--	--

2B: Punë me të dhëna dhe zgjidhje e problemeve

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe material)	Komente
<p>Organizim, kategorizim dhe paraqitje e të dhënave</p> <p>Përgjigjet në pyetje me mbledhjen dhe përshkrimin e të dhënave në lista dhe tabela dhe në mënyrë figurative i paraqet me diagrame, piktograme për të treguar rezultatet.</p>	<p>Kupton dhe fillon të përdorë terminologjinë lidhur me punë me të dhëna: zgjedh, vendos, paraqet, tabelë, diagram, listë, numërim, mbishkrim, më e madhe/më e vogël, i rëndomtë/popullarizuar.</p> <p>Zgjidhje e problemeve si psh: Çka duam të bëjmë në shtëpi? Përdorni diagram shtyllë për prezantim të të dhënave. Diskutoni për qasjet e hulumtimit. Çka më shumë/më pak duan të bëjnë shumica e nxënësve? Pse mendoni se është ashtu? Sa nxënës pyetëm? Kërkoni nga nxënësit të mendojnë pyetje të tjera</p> <p>Vërtetim i hipotezës: Ushqimi jonë I preferuar është patatja. Mblidhni të dhëna (duke e ngritur dorën). Bëni një program të thjeshtë duke përdorur simbole, ku secili simbol përfaqëson një njësi.</p>	<p>Kube të cilat kanë lidhshmëri mes tyre.</p>	<p>Diskutoni: Si mund ta dimë (zbulojmë)? Si do ti organizojmë informacionet?</p> <p>Diskutoni për pyetjet ashtu si janë: Sa fëmijë më shumë duan patate? Sa aspak nuk e duan? Cili është ushqimi i preferuar në paralele? Sa fëmijë u pyetën?</p> <p>Nxisni bisedë në paralele për kriteret dhe arsyet për kategorizimin e të dhënave.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe material)	Komente
<p>Përdor diagramet Kerolit dhe Venit për shpërndarje të numrave dhe objekteve duke përdorur një kriteri; fillon të përdorë dy kritere; e arsyeton zgjedhjen duke përdorur gjuhë përkatëse, përfshirë edhe fjalën "jo"</p>	<p>Kur keni para vetes më shumë objekte, forma pyesni nxënësit si mund ti grupojmë këto forma? Diskutoni për mënyra të ndryshme. Filloni me një kriter për grupimin e tyre, dhe kur nxënësit do të arrijnë siguri përdorni dy kritere për grupim të atyre objekteve, formave. Sqaroni diagramin e Venit dhe Kerolit. Zgjidhni tabelë dhe kritere për grupim. Diskutoni me nxënësit për vendosje të secilës formë. Përsëritni me objekte të tjera që të gjithë nxënësit të njihen dhe kuptojnë grupimin dhe diagramet.</p>	<p>Objekte për grupim.</p>	
<p>Zgjidhje e problemeve Të zbatuarit e teknikave dhe shkathtësive për zgjidhje të problemeve</p> <p>Gojarisht e sqaron mënyrën e zgjidhjes dhe të menduarit.</p> <p>E përdor diturinë për zgjidhje të problemeve dhe enigmave.</p>	<p>Gjatë zgjidhjes së problemeve me të dhëna nxënësit motivohen të japin idetë e tyre dhe të tregojnë arsyet për zgjedhjen e strategjive për zgjidhjen e problemeve.</p> <p>Arsimtari parashtron pyetje të cilat secilit nxënës i mundësojnë të kuptojë problemin dhe ti ndihmojë të zgjidh të njëjtin: Çfarë do të ndodh nëse? Si e dini? A do të jetë çdoherë njësoj?</p>	<p>„Bankë” idesh, radhitëse dhe probleme.</p> <p>Shfrytëzim të ideve të shpallura dhe ideve personale.</p>	<p>Parashtrim të pyetjeve të hapura do të ju mundësojë nxënësve të flasin për atë që e dinë dhe e kuptojnë.</p> <p>Parashtrim i problemeve të cilat duhet të zgjidhen, të cilat janë në kontekst të jetës reale, do të ju mundësojë nxënësve ta shfrytëzojnë dhe zbatojnë dituritë dhe shkathtësitë e tyre.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe material)	Komente
<p>I kupton detyrat e thjeshta tekstuale (në një ose dy hapa), përcakton cilët operacione janë të nevojshme (mbledhje ose zbritje, shumëzim ose pjesëtim) për zgjidhjen e tyre dhe me ndihmë i paraqet me objekte, me vizatime ose numra.</p> <p>Jep mendimin e tij nëse një përgjigje është e arsyeshme (e kuptimtë).</p>	<p>Parashtroni pyetje për të cilat është e nevojshme mbledhje dhe organizim i të dhënave me qëllim që atyre tu përgjigjen, ose vërtetoni hipotezë me të dhëna të cilat do ta vërtetojnë atë ose jo.</p> <p>U jepen mundësi nxënësve të potencojnë arsyet për përgjigjen e tyre, duke ju mundësuar që ti përshtatin (adaptojnë) ose ndryshojnë përgjigjet e tyre.</p>		<p>Jo të gjithë nxënësit detyrimisht do të japin përgjigje të njëjtë, por duhet të munden të potencojnë arsyet për zgjidhjet e tyre.</p>

2B: Matje dhe zgjidhje e problemeve

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p><i>Njësi matëse</i> <i>Paratë</i></p> <p>I njeh të gjithë monedhat dhe bankënotat.</p> <p>Përdor sistem për shënim të të hollave deri në 100.</p> <p>E përcakton shumën e monedhave dhe bankënotave të nevojshme për të paguar një shumë të caktuar prej 100 denarë dhe e llogarit sa para duhet ti kthehen.</p> <p><i>Gjatësia, pesha dhe vëllimi</i></p> <p>Llogarit, mat dhe krahason gjatësi,</p>	<p>Dallon vlerën e të gjithë monedhave dhe bankënotave. Organizohet lojë rolesh „në shitore”. Shënohet çmimet e prodhimeve, dhe nxënësit luajnë rolin e blerësit dhe shitësit. Vendosje e etiketave në artikuj në “shitore”.</p> <p>Blerësve ju jepet një shumë e caktuar parash për të harxhuar. Blini 3 produkte! Sa të holla janë harxhuar? Sa të holla kanë mbetur? Sa artikuj të ndryshëm mund të blini me paratë që i keni? Cili është produkti më i dashur të cilin mund ta blini? Shitësit duhet të llogarisin sa të holla duhet ti kthejnë blerësit.</p> <p>Të kuptuarit dhe përdorim përkatës të simboleve për njësi standarde për gjatësinë, peshën dhe vëllimin. Përdorni njësi standarde dhe</p>	<p>Monedha dhe bankënota të vërteta. Çmimet e artikujve. Etiketa për artikujt.</p> <p>Monedha dhe bankënotë të vërteta. Prodhime për blerje. Etiketa për artikujt në shitore.</p> <p>Listë për blerje.</p> <p>Letra me simbole për njësi standarde. Instrumente për matje, standarde dhe jostandarde.</p>	<p>Përdorimi i të hollave të vërteta ju mundëson nxënësve të krijojnë lidhje me jetën reale.</p> <p>Bëni etiketa të ndryshme për nxënës me aftësi të ndryshme në paralele. Etiketat mund të ndryshohen sipas pjesëmarrjes së nxënësve në momentin e caktuar kohor. Blerësve mund të ju jepen monedha me vlerë të ndryshme. Shkruani listë për blerje për çifte të ndryshme ose grup nxënësish sipas aftësive të tyre.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>peshë dhe vëllim duke zgjedhur dhe shfrytëzuar njësi përkatëse standarde dhe jostandarde dhe instrumente përkatëse për matje.</p> <p>I krahason gjatësitë, peshën dhe vëllimin duke përdorur njësi standarde: centimetër, metër, 100gr, kilogram dhe litër.</p> <p><i>Koha</i></p> <p>I di njësitë për kohën (sekonda, minuta, ora, dita, java muaji dhe viti).</p> <p>E di raportin ndërmjet njësive vijuese për kohën.</p> <p>Lexon kohën deri në gjysmë ore në orë digjitale dhe analoge.</p>	<p>jostandarde për matje dhe zgjidhje të problemeve në situata të ndryshme praktike.</p> <p>Loja „pazar”, „shitore” në të cilën nxënësit masin objekte: kjo cope basme (tekstil) është më e gjatë/më e shkurtër se një metër/centimetër, kjo kuti është më e rëndë/më e lehtë se kilogram/100gram, kjo enë përmban më shumë/më pas se një litër/500 mililitër.</p> <p>Të kuptuarit, përdorimi dhe fillimi i të lexuarit të fjalorit për kohën.</p> <p>Loja me role „aeroport”. Çifte nxënësish luajnë rolin e kontrolluesve të fluturimit dhe nëpunës për kontrollë. Shpërndani biletat për fluturim të vendmbërritjeve të ndryshme në paralele (1 për grup).Tregoni orë digjitale dhe analoge-12orëshe. Pyesni kush fluturon deri në Gjermani? Kur niset aeroplani juaj? Kërkoni nga çifti kontrollues ta tregojnë kohën në orën</p>	<p>Aparate, standarde dhe jostandarde.</p> <p>Letra me fjalë, për njësi për matje.</p>	<p>Puna në çifti ju mundëson nxënësve të përfitojnë më shumë siguri. Puna në grup nxit diskutim.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Bën matjen e kohëzgjatjes së disa veprimtarive duke përdorur sekondat dhe minutat.</p> <p>I di dhe i radhit ditët e javës dhe muajt e vitit.</p>	<p>analoge. Përsëritni të njëjtën për fluturime në shtete tjera. Çdo udhëtarë duhet të kaloj kontrollin 2 orë para fluturimit. Çifti i nëpunësve e tregon kohën e duhur.</p> <p>Në të njëjtën lojë me role shfrytëzoni orarin rrugor (për fluturim) në të cilin aeroplanët fluturojnë në çdo gjysmë ore.</p> <p>Zgjidhni Veprimtaritë nxënësish të cilat do të realizohen në periudhë prej disa sekondash ose minutash dhe matni psh: Nxitim në palestër/fushë sporti/fushë, shkruaj emrin 10herë, uluni dhe ngrihuni 6 herë.</p> <p>Bëhen letra me emra të ditëve të javës dhe muajve të vitit. Në lojë letrat përzihen dhe vendosen me fytyrë mbrapsht. Nxënësit kthejnë nga një letër, e lexojnë dhe e vendosin në vendin përkatës sipas radhitjes.</p>	<p>Biletë aeroplani Kartë për fluturim Orë digjitale-12 orësh Orë analoge Biletë aeroplani Kartë për fluturim Orë digjitale-12 orësh Orë analoge Orë rëre Kronometër Bileta</p>	<p>Kërkoni nga nxënësit të propozojnë ide të tjera.</p> <p>Kjo mund të luhet me të gjithë nxënësit ose me çift nxënësish. Për disa nxënës biletat do të kenë ilustrime bashkë me fjalë.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Zgjidhje e problemeve</p> <p>Zgjedh dhe përdor strategji mentale përkatëse për llogaritje dhe e sqaron mënyrën se si erdhi deri te përgjigjja.</p> <p>Gojarisht sqaron mënyrën e zgjidhjes dhe të menduarit.</p> <p>Shfrytëzon diturinë për zgjidhje të problemeve dhe enigmave.</p> <p>I kupton detyrat e thjeshta tekstuale (në një ose dy hapa), përcakton cilët operacione janë të nevojshme (mbledhje ose zbritje, shumëzim ose pjesëtim) për zgjidhjen e tyre dhe me ndihmë i paraqet me objekte, me vizatime ose numra.</p> <p>Mendon ndodhi për detyrën e dhënë, përfshirë në të edhe të hollat.</p>	<p>Gjenden mënyra të ndryshme për harxhim të një shume të caktuar parash.</p> <p>Qeni im është 30cm më i gjatë se qeni yt. Qeni yt është 45 cm i gjatë. Sa i gjatë është qeni im?</p> <p>Keni 70 litër ujë. Sa kova prej 10 litrash ujë mund të mbushni me atë?</p> <p>Shkova në shitore në ora 12:15 dhe u ktheva në ora 2:45. Sa gjatë kam qenë në shitore?</p> <p>Ofroni mundësi nëpërmjet leksioneve.</p> <p>Shfrytëzoni ide të lidhura me njësitë për matje.</p> <p>Duke shfrytëzuar Veprimtaritë të lira ku nxënësit mund të sjellin vendime të tyre psh: Loja me role.</p> <p>Me zbatim të lojës me role, nxënësit mendojnë histori të veta, si psh: për blerje ose udhëtim dhe i shënojnë në mënyrën e tyre.</p>	<p>Para të vërteta.</p> <p>Vizore, lenta për matje (metër).</p> <p>Gota, shishe etj., të shënuara me litër.</p> <p>Orë analoge dhe digjitale.</p>	

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>E vërteton përgjigjen të një detyre me mbledhje të numrave me radhitje të ndryshme dhe përdorim të strategjive të ndryshme, si psh: 35+19 me mbledhje të 35 dhe 20 dhe zbritje të1, dhe me mbledhje të 30+10 dhe 5+9.</p> <p>E vërteton zbritjen duke përdorur mbledhjen.</p> <p>Bën vlerësim të kuptueshëm (arsyeshëm) të përgjigjes së një detyre.</p> <p>Jep mendimin e vet nëse përgjigja është e arsyeshme.</p>	<p>Të zbatuarit e diturive të nxënësve përmes lojërave në role.</p> <p>Të zbatuarit e diturive të nxënësve përmes lojërave në role.</p> <p>Lojë me role.</p> <p>Lojë me role.</p>		

3A: Numra dhe zgjidhja e problemeve

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Numra dhe sistem numrash</p> <p>Numëron nga dy, nga pesë dhe nga dhjetë dhe përdor grupimin nga dy, pesë dhe dhjetë që të numërojë grupe më të madh të objekteve deri në 100.</p> <p>Fillon të numërojë gradualisht me hapa të vogla, nga 3 deri në 30 dhe nga 4 deri në 40 psh. 3, 6, 9...27, 30 dhe 4, 8, 12...36, 40.</p>	<p>Duke filluar nga 0, e pastaj nga cili do numër njëshifror, nxënësi numëron nga 2, 5 dhe 10 deri më 100 dhe më shumë.</p> <p>Shfrytëzoni rrjet me numra 2x2 dhe vazhdoni numërimin nga 2 duke filluar nga 1. Rrethoni çdo numër të dytë. Çfarë vëreni? Çfarë mund të thoni për numrat e rrethuar (numra tek). Shfrytëzoni rrjetin numëror 3x3. A është model i njëjtë? Çka është ndryshe? Çfarë mendoni se do të ndodhë me rrjetin e numrave 4x4, 5x5, 6x6.</p> <p>Filloni nga cili do numër dhe vazhdoni me numërim nga 1 deri në 100 dhe anasjelltas (mbrapsht). Përsëritni. Filloni me numër dyshifror dhe numëroni nga 10 deri më 100 dhe mbrapsht.</p> <p>Filloni nga cili do numër dhe vazhdoni nga 3 ose 4.</p>	<p>Tabela „Qindëshe”</p> <p>Tabela „Qindëshe”</p> <p>Varg numrash</p> <p>Kalkulator</p>	

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Njeh se një gjysmë shkruhet</p>	<p>Veprimtaritë praktike në të cilat bëhen gjysma dhe një të katërta me shpalosje të letrës. Prisni secilën pjesë dhe njëkohësisht shënoni edhe me fjalë dhe me simbol (numër) për gjysmë dhe një të katërtën.</p> <p>Shfrytëzoni forma të ndryshme dhe përsëritni.</p> <p>Vendosni 2 gjysma të prera bashkë, që të tregoni se një gjysmë plus një gjysmë tjetër (2/2 ose 2 gjysma) bëjnë një bashkë. Përsëritni në forma të thjeshta dhe të ndryshme dhe përsëritni me 4 çerek.</p> <p>Shfrytëzoni forma të prera për të treguar thyesat. Çka vëreni? Gruponi, ndani të gjitha format duke u treguar $\frac{1}{2}$, $\frac{1}{4}$ në grupe. Gruponi, ndani format që nuk tregojnë $\frac{1}{2}$ ose $\frac{1}{4}$ në grup tjetër.</p> <p>Përdorni letër të thyer për të fituar gjysma dhe një të katërta (çerek) duke përdorur forma të rregullta dhe jo të rregullta. Çka mund të vëreni për format jo të rregullta.</p> <p>Gruponi ose shpërndani objektet për të treguar gjysma dhe një të katërtën. Çka nëse ka ndonjë mbetje.</p>	<p>Forma prej letre. Gërshërë</p> <p>Forma të përgatitura me thyesa të prera.</p> <p>Forma të rregullta dhe jo të rregullta</p> <p>Objekte, mjete</p>	<p>Fëmijët angazhoni me punë praktike para se të punojnë me materiale abstrakte. Kjo do të ndihmojë në zhvillim të të kuptuarit.</p> <p>Përsëritja e tabelave ju mundëson nxënësve më pak të Në mënyrë të sigurt të marrin pjesë në atë që e dinë dhe të dëgjojnë atë që nuk e dinë.</p> <p>Gjithashtu nxënësit mund t'ju parashtrojnë pyetje edhe bashkëpjesëmarrësve në paralele.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Llogaritje</p> <p>I di të gjitha çiftet e numrave shuma e të cilëve është 10 dhe çifteve shuma e të cilëve është 20.</p> <p>I mëson dhe dallon, njeh numrat që fitohen me numërim nga 2, 5 dhe nga 10 dhe i shqyrton, analizon faktet përkatëse për shumëzim.</p> <p>E di se çka paraqet ç'do shifër te numrat dyshifror dhe i ndan (zberthen) në dhjetëshe dhe njëshe.</p> <p>Radhit numra deri më 100; krahason dy numra duke i shfrytëzuar shenjat „>“ dhe „<“.</p>	<p>Përsëritje të çiftesh numrash shuma e të cilëve është 10 dhe çifte numrash shuma e të cilëve është 20.</p> <p>Të gjithë nxënësit përsërisin numërimin nga 2, nga 5 dhe nga 10.</p> <p>Të kuptuarit e vlerës vendore të numrave. Njohja e zeros si bartës i njësheve në numrat dyshifror. Të kuptojnë se 83 është $80 + 3$. Çka paraqet shifra 9 në numrin 29? Dhe çfarë te 98? Çka është 4 te numri 84, dhe çka është 9 te numrat 89 dhe 29? Sqaroni cili numër duhet të jetë tek shenja trekëndësh? $45 = ? + 7$ $75 = 28 + ?$</p> <p>Pyetje: cili është më i vogël se...?; cili numër është më i madh se...? Vendosni numrat në varg numerik të zbrazur (bosh). Hyrje, njohje me shenjat „<“ dhe „>“ Ilustrim me shembuj. Numrat tregohen në vargun numerik dhe gjendet dallimi ndërmjet tyre.</p>	<p>Tabela “Qindëshe”</p> <p>Karta me vlera të shënuara (shigjeta)</p> <p>Tabela “Qindëshe” Varg i zbrazët për numra Afishë, poster me shenja „<“ и „>“.</p>	<p>Shënoni faktet për vlerat e dyfishta, ashtu që të gjithë nxënësit do të mund t'i shikojnë.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Strategji mendore</p> <p>I njeh dhe i mëson vlerat e dyfishta të të gjithë numrave deri në 10, si dhe numrat 15, 20, 25 dhe 50.</p> <p>Mbledhje dhe zbritje</p> <p>Mbledh/zbret numër njëshifror me/nga numër dyshifror.</p> <p>Lidh numërimin para/mbrapsht (anasjelltas) nga 10 që të gjejë numër i cili është për 10 më i madh/i vogël nga cilido numër dyshifror, pastaj mbledh dhe zbret numër dyshifror me dhjetëshe të plota, si psh.: 75 - 30</p> <p>Mbledh çifte nga numrat dyshifror.</p>	<p>Veprimtaritë praktike për gjetjen e vlerave të dyfishta të të gjithë numrave deri në 10. Përsëritje të fakteve për vlera të dyfishta deri në 10. Shfrytëzoni fakte të njohura për t'i parë, shqyrtuar vlerat e dyfishta të numrave nga 1 deri në 15; vlerat e dyfishta të 5, 10, 15, 20, 25 dhe 50.</p> <p>Shfrytëzimi i ndihmës vizuale siç është tabela „qindëshe” ose varg numrash për të numëruar para (mbledhje) dhe numërim mbrapsht (zbritje)</p> <p>Hulumtim i modelit për mbledhje dhe zbritje të numrave me 10, duke përdorur tabelën “qindëshe”.</p> <p>Ndarja e numrave dyshifror në dhjetëshe dhe njëshe dhe zbatim i asaj diturie për mbledhje të çifteve të numrave dyshifror me shfrytëzim të tabelës „qindëshe”.</p>	<p>Varg numrash</p> <p>Kalkulatori</p> <p>Tabela “Qindëshe”</p> <p>Tabela “Qindëshe”</p> <p>Tabela „Qindëshe”</p> <p>Karta për shënim të vlerës (shigjetë)</p>	<p>Sa më shumë që nxënësit e shfrytëzojnë tabelën “qindëshe”, aq më shpejtë largohen nga praktikumi dhe tabela „njëqind” mbetet fotografi mendore.</p> <p>Disa nxënësve do tu duhet më shumë praktikë se sa të tjerëve.</p> <p>Varësisht prej numrave të përdorur, ndonjëherë ka kuptim të vazhdojmë me numërim se sa zbritje.</p> <p>Fjongo (shirit) prej kartoni ku llogaritja është e shkruar horizontalisht. Sipër fjongos lëviz një gyp prej kartoni, e cila mund të mbuloj cilin do numër në çdo kohë.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Gjen dallim të vogël ndërmjet çifteve të numrave dyshifror.</p> <p>Njih zbatimin e simboleve siç janë: \triangle ose \square për të treguar numra të panjohur, si psh.: $\triangle + \square = 10$.</p> <p>Zgjidh barazime si psh.: $27 + \triangle = 30$</p> <p>Shumëzim dhe pjesëtim</p> <p>Kupton pjesëtimin si grupim dhe shfrytëzon shenjën „:“.</p> <p>Shfrytëzon numërim nga dy, nga pesë dhe nga dhjetë për zgjidhje praktike të problemeve.</p>	<p>Me shfrytëzimin e tabelës “qindëshe” zbatohet strategjia për numërim mbrapsht nga numri më i madh ose numërim para nga numri më i vogël. Ofroni të dy strategjitë.</p> <p>Përsëritni dhe shfrytëzoni dituritë e nxënësve për çiftet e numrave shuma e të cilëve është 10 për zgjidhje detyrash. Gjeni të gjitha mundësitë. Përdorni diturinë e nxënësve për çiftet e numrave për zgjidhje të detyrave me mbledhje deri më 20.</p> <p>Shfrytëzim të fakteve të njohura për numrat dhe njohje të vlerës mesatare të numrave për të zgjidhur detyra ku numri i panjohur është në vende të ndryshme në paraqitjen numerike. (barazim, ekuacion).</p> <p>Të kuptuarit e operacionit pjesëtim si grupim ose zbritje e përsëritur. Shkruani detyra të thjeshta me numra, duke zbatuar shenjat „:“ dhe „=“.</p> <p>Filloni nga cilido numër dhe numëroni para nga 2, nga 5 dhe nga 10</p>	<p>Tabela “Qindëshe”</p> <p>Fjongo rrëshqitëse me numra.</p> <p>Fjongo rrëshqitëse me numra.</p> <p>Mjete për llogaritje</p> <p>Tabela „Qindëshe”</p>	

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>E di se gjatë pjesëtimit mund të ketë edhe mbetje.</p> <p>Bën ndarjen e numrave 5, 10, 15,...45, 50 dhe numrat e fituar përgjysmon.</p> <p>Bën ndarjen e numrave dyshifror.</p> <p>Numëron nga 3 dhe 4, si hyrje në tabelën për shumëzim dhe pjesëtim.</p>	<p>dhjetëshe. Shfrytëzoni mbledhje të përsëritur (numërim para) për zgjidhjen e problemeve praktike siç është: pesë kutia të vogla hyn në një kuti të madhe. Sa kutia të vogla do të kemi nëse kemi 6 kutia të mëdha?</p> <p>Numëroni 10 objekte. Ndani në dy grupe të barabarta. Largoni disa objekte. Ndani objektet e mbetura. Çfarë ndodh? Ka mbetje? Përsëritni disa herë ashtu që do të përfshihen të gjitha numrat nga 1 deri në 10. Shënoni numrat që ndahen pa mbetje, dhe ato që ndahen me mbetje. Proveni me numra më të mëdhenj. Shënoni numrat që kanë mbetje dhe ato që nuk kanë. Shfrytëzoni tabelën “qindëshe” për të shënuar. Çfarë vëreni?</p> <p>Si do ta bëni këtë? Diskutoni strategjitë për ndarje.</p> <p>Ndani dhjetëshet, ndani njëshet, mblidhni bashkë, ndani dhjetëshet, mblidhni bashkë; shtoni dhjetëshet numrit të parë, pastaj shtoni njëshet... Bisedoni me nxënësit për atë se cilën mënyrë e kanë më të lehtë.</p> <p>Të kuptuarit se pjesëtimi është e kundërta e shumëzimit. Shfrytëzoni</p>	<p>Përgatitje për numërim. Tabela „Qindëshe” për regjistrim</p> <p>Varg numrash. Tabela “Qindëshe”</p> <p>Tabela „Qindëshe”</p> <p>Përgatitje për numërim.</p>	

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
	<p>tabelën „qindëshe” që të gjeni tabela për numërim nga 3 dhe 4.</p> <p>Shfrytëzoni fjalorin e shumëzimit (mbledhje e përsëritur) dhe pjesëtimit (grupim/zbritje të përsëritur) kur gjeni fakte për shumëzim dhe pjesëtim.</p> <p>Sqaroni 10 pjesëtuar me 2 se sa dysha bëjnë një dhjetëshe.</p>		

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Zgjidhje e problemeve</p> <p>Zgjedh dhe përdor strategji mentale përkatëse për llogaritje dhe e sqaron mënyrën se si erdhi deri te përgjigjja.</p> <p>Gojarisht e tregon, paraqet mënyrën e zgjidhjes dhe të menduarit</p> <p>E shfrytëzon diturinë për të zgjidhur probleme dhe enigma</p> <p>I kupton detyrat e thjeshta tekstuale (në një ose dy hapa), përcakton cilët operacione janë të nevojshme (mbledhje ose zbritje, shumëzim ose pjesëtim) për zgjidhjen e tyre dhe me ndihmë i paraqet me objekte, me vizatime ose numra.</p> <p>Mendon ndodhi për detyrën e dhënë, përfshirë në të edhe të hollat.</p> <p>E vërteton përgjigjen të një detyre me mbledhje të numrave me radhitje të</p>	<p>Për të gjitha llogaritjet, pyesni nxënësit. Si do ta bënin atë? Filloni me atë që nxënësit e dinë për të zbuluar atë që nuk e dinë.</p> <p>Nxënësve jepni mundësi për të shqyrtuar strategjitë e tyre (vetjake) për zgjidhje të detyrave.</p> <p>Nxënësit zgjedhin dhe përdorin operacione përkatëse me numra dhe mënyra të ndryshme llogaritjeje për zgjidhje të problemeve të ndryshme.</p> <p>Zgjidhje të detyrave të thjeshta të parashtruara gojarisht nga situata të “jetës reale”. Përdorni strategji personale për zgjedhje të operacioneve përkatëse. Gojarisht sqaroni metodat dhe rezonimin.</p> <p>Çka mund të jetë ngjarja për $18 - 12 = 6$?</p> <p>Keni 18 sheqerka, unë i hëngra 12, ashtu që mbetën 6.</p> <p>Kjo duhet të vlejë për të gjitha llogaritjet.</p> <p>Kjo duhet të vlejë për të gjitha llogaritjet.</p>		

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjete dhe materiale)	Komente
<p>ndryshme dhe përdorim të strategjive të ndryshme, si psh: 35+19 me mbledhje të 35 dhe 20 dhe zbritje të 1, dhe me mbledhje të 30+10 dhe 5+9.</p> <p>E vërteton zbritjen duke përdorur mbledhjen.</p> <p>E përshkruan dhe e vazhdon vargun me numërim nga dy, nga tre, nga katër dhe nga pesë deri në 30 ose më shumë</p>	<p>Përdorimi i tabelës „qindëshe”. Përdorimi i kalkulatorit.</p>		

3B:Gjeometria dhe zgjidhja e problemeve

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Gjeometria</p> <p>Grupon, vizaton, përshkruan, mendon dhe vizaton 2D forma (për shembull: katror, drejtkëndësh, rreth, pesëkëndësh i drejtë dhe jo i drejtë dhe gjashtëkëndësh) sipas vetive të tyre. I njeh 2D format në pozicione të ndryshme.</p> <p>Grupon, emëron përshkruan 3D forma (psh: kub, kuadër, kon, cilindër, top dhe piramida) sipas vetive të tyre; I dallon 2D format prej 3D formave.</p> <p>Cakton simetrinë tek 2D format dhe e vizaton vijën e simetrisë.</p>	<p>Të kuptuarit, të zbatuarit dhe fillimi i leximit të terminologjisë për 2D forma. Nxënësi zgjedh forma konkrete dhe i përshkruan. Arsimtari mund të parashtrojë kritere: Zgjidhni formë të një tehu të thyer ; 4 kënde dhe 4 faqe...</p> <p>Gruponi 2D forma sipas vetive: numri i teheve, numri i këndeve; faqe të drejta ose të thyera.</p> <p>Përdorimi, kuptimi dhe fillimi i leximit me fjalor për simetrinë. Të njihen me vizatimin e vijave të simetrisë. Përshkrimi i vijës simetrike dhe përshkrimi i modeleve simetrike nga jeta reale si ato që janë të fituara nga ngjyra, njolla me bojë shkrimi (ngjyrë lapsi),format nga letra, kube që ndërliken ndërmjet veti.</p> <p>Mblidhni shembuj nga 2D dhe 3D forma 3D:kuti, paketime, modele.....</p> <p>Gruponi dhe etiketoni.</p>	<p>Karta me fjalë për 2D forma.</p> <p>Komplet nga forma të drejta.</p> <p>Komplet nga 2D forma.</p> <p>Pasqyra.</p> <p>Pëlhura, tapet, ngjyrë, bojë shkrimi, pllaka paneli të performuara, forma letre dhe kube që lidhen ndërmjet veti...</p> <p>2D dhe 3D forma.</p> <p>Paketimi dhe shembuj të ndryshëm të formave 3D.</p> <p>Mbishkrime.</p>	<p>Kartat mund të jenë vetëm fjalë, fjali me ilustrime ose fjali me fotografi.</p> <p>Ky aktivitet mund të lidhet me diagramin e Karolit dhe Venit.</p> <p>2D format nuk kanë thellësi dhe</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Gjen shembuj të 2D dhe 3D formave dhe simetri nga mjedisi.</p> <p>Pozita dhe lëvizja</p> <p>Përcjell dhe jep udhëzime për pozitën, drejtimin dhe lëvizjen.</p> <p>Dallon të plotën, gjysmën dhe të katërtën e rrotullimit, në drejtim të lëvizjes të shigjetave të orës dhe në drejtim të kundërt.</p> <p>Njeh(dallon) që këndi i drejtë është</p>	<p>Kuptimi, përdorimi dhe fillimi i leximit të fjalorit për përshkrim të pozicionit dhe lëvizjes.</p> <p>Përgjigje të instruksioneve gojore ose instruksione në formë të shkruar me vizatime ose objekte të pozicionuara.</p> <p>Përpunimi i hartave për „pasuri të fshehur”. Dhënia e udhëzimeve për zbulimin e pasurisë.</p> <p>Të kuptuarit dhe fillimi i leximit të nocioneve, rrotullim dhe kënd.</p> <p>Gjatë vallëzimit ose edukimit fizik, rrotulloheni në vend me rrotullim të plotë, me gjysmë rrotullim dhe çerek rrotullim. Rrotullohuni në drejtim të shigjetave të orës dhe në drejtim të kundërt të shigjetave të orës.</p> <p>Përdorni karta me fotografi si udhë rrëfim që të bëni rrotullime.</p>	<p>Karta me nocione.</p> <p>Karta me nocione.</p> <p>Karta me fotografi për udhë rrëfim.</p>	<p>për atë përdorni forma të holla dhe të drejta dhe sqaroni cila është fytyra e formës 2D.</p> <p>Kartat mund të jenë vetëm fjalë, fjali me ilustrime ose fjali dhe fotografi me përputhshmëri (ngjashmëri).</p> <p>Mund të dizajnohen 2D ose 3D harta. Nxënësit mund të punojnë bashkërisht për tu nxitur diskutimi.</p> <p>Kartat mund të jenë vetëm fjalë, fjali me ilustrime ose fjali dhe fotografi me përputhshmëri (ngjashmëri).</p> <p>Kartat tregojnë lëvizjen dhe fjalët.</p> <p>Çdo grup zgjedh nga 4 ose 5 karta që të fitojnë disa lëvizje dhe pastaj i këmbëjnë me nxënësit e tjerë në klasë.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
çerek rrotullim.	<p>Në klasë gjeni shembuj të këndit të drejtë: dritare, derë, banka, libra....</p> <p>Lëvizni në tehet e tavolinës (bankës) dhe diskutoni çfarë do të ndodhë nëse ndërrohet drejtimi i lëvizjes .</p> <p>A ndodh kjo çdo herë kur kemi kënd të drejtë?</p> <p>Gruponi këndet në kënde të drejta(me çerek rrotullim)dhe kënde jo të drejta (më shumë dhe më pak nga çerek rrotullimi).</p>	Karta që tregojnë kënde të ndryshme.	Aktiviteti me grupim, mund të përdoret edhe për përmirësimin e punës me diagramin e Venit dhe Karolit.

3C. Matje dhe zgjidhja e problemeve

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse(mjete dhe materiale)	Komente
<p>Njësi matëse I njeh, dallon të gjitha monedhat dhe bankënotat.</p> <p>Shfrytëzon sistemin për përcaktimin e vlerës prej 100 den.</p>	<p>Kjo njësi mund të përpunohet në dy mënyra të ndryshme. Të mbetet si është, ose të ndryshojnë shumat e parave, për të bërë më të komplikuar për të fituar fakte për përparim të nxënësit. Ose të ndërrohet shembulli me pjesët e lojës në role. Që të dy shembujt do të kontribuojnë në përmirësimin e mundësive të nxënësve që kanë nevojë.</p> <p>Të dallojnë vlerën e të gjithë monedhave dhe bankënotave. Loja në role” në shitore”. Në shitore shiten produkte, ato kanë çmimin e tyre, në shitore punojnë shitës dhe hyjnë për të blerë blerësit. Çdo produkt ka etiketë me çmim.</p> <p>Blerësve u është dhënë shuma e parave për harxhim. Blini nga 5 produkte! Sa keni harxhuar? Sa para ju mbetën? Sa produkte të ndryshme mund të blini me parat që keni? Cili është produkti më i shtrenjtë që mund ta blini?</p>	<p>Monedha dhe bankënota të vërteta. Çmime. Etiketa.</p> <p>Etiketa.</p>	<p>Përdorimi i parave të vërteta u mundëson nxënësve që të bëjnë lidhjen me jetën reale.</p> <p>Përdorni i etiketave të ndryshme që ti lexojnë nxënësit ,me aftësi në nivele të ndryshme. Etiketat mund të ndryshohen sipas pjesëmarrjes së nxënësve në moment të duhur.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse(mjete dhe materiale)	Komente
<p>Përcakton shumën monedhave dhe bankënotave të nevojshme për të paguar shumën e caktuar deri më 100 denarë dhe e llogarit sa duhet ti kthejnë.</p> <p>Llogarit, mat dhe krahason gjatësinë, peshën dhe vëllimin duke përdorur njësi matëse standarde dhe jostandarde, instrumente përkatëse për matje.</p> <p>I krahason gjatësitë, peshën dhe vëllimin duke shfrytëzuar njësi standarde matëse:cm,m,100g,kg dhe litër.</p> <p>I njeh njësitë matëse për kohën (sek, min, h, dita, java, muaji dhe viti).</p> <p>E di raportin kohor ndërmjet njësive matëse vijuese.</p>	<p>Shitësit duhet të llogarisin sa para duhet të kthehet nëse blerësi ka dhënë më tepër para.</p> <p>Kjo njësi mund të ndërlidhet me lojë në role dhe zmadhim të vlerës së parave.</p> <p>Të kuptuarit dhe përdorimi për lexim fillestar me simbole për matje të gjatësisë, peshës dhe vëllimit. Shfrytëzoni njësi matëse standarde dhe jostandarde, për matje gjatë zgjedhjes së problemeve të ndryshme.</p> <p>Nxënësit bëjnë matjen dhe tregojnë: Ky shirit është më i gjatë, më i shkurtër në cm. Kjo qese është më e rëndë se tjetra për 100g.Kjo kovë nxë më shumë/më pak se l/500ml.</p> <p>Të kuptuarit dhe përdorimi fillestar i leximit me fjalor për kohën.</p> <p>Për lojën zgjidhni çifte të nxënësve që të luajnë rolin e kontrollorit për fluturim dhe nëpunësit që çekojnë (në aeroport).</p> <p>Ndani bileta për fluturim në vendmbërritje të ndryshme për të gjithë</p>	<p>Monedha dhe bankënota të vërteta. Çmime. Etiketa. Listë për blerje.</p> <p>Karta me simbole.</p> <p>Pajisje të ndryshme për matje.</p> <p>Karta me njësi matëse për kohën.</p> <p>Bileta aeroplani. Bileta për fluturim.</p>	<p>Blerësve mund tu jepen monedha dhe shuma me vlera të ndryshme.</p> <p>Përdorni lista të ndryshme për blerje, për nxënësit me nivele të ndryshme të aftësisë.</p> <p>Puna në çifte mundëson që nxënësit të jenë më të sigurt.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse(mjete dhe materiale)	Komente
<p>E lexon kohën deri në gjysmë ore në orë digjitale dhe analoge.</p> <p>Mat kohëzgjatjen e disa veprimtarive me sek. dhe min.</p> <p>I di dhe i radhit ditët e javës dhe muajt e vitit.</p>	<p>nxënësit (në grupe) dhe bileta për çdo grup. Tregojuni orë digjitale dhe analoge Pyesni-Kush fluturon për Gjermani? Kur fluturon aeroplani juaj? Kërkoni çiftin e kontrollorëve të cilët duhet të tregojnë kohë në orën analoge. Përsëritni këtë, për fluturime në shtete të ndryshme. Çdo udhëtar duhet të bëjë çeking 2 orë para fluturimit. Çifti i punëtorëve për çeking e tregojnë kohën.</p> <p>Loja si ajo e mëparshmja, por tani aeroplanit fluturojnë çdo gjysmë ore.</p> <p>Matet kohëzgjatja e disa veprimtarive të nxënësve: vrapim në sallë/fushë sporti, livadh ose caktimi i kohës për shkrimin e emrit të vetë nxënësit 10 herë, ulje dhe ngritje 6 herë...</p> <p>Përdorimi i kartave për emrat e ditëve të javës dhe muajve të vitit. Kartat përzihen dhe kthehen mbrapsht. Hapet një kartë dhe vendoset në vendin e duhur sipas radhitjes.</p>	<p>Orë digjitale 12-orësh.</p> <p>Orë analoge.</p> <p>Bileta për aeroplan. Karta për fluturim. Orë digjitale 12-orësh Orë analoge.</p> <p>Matës me rërë. Kronometër.</p> <p>Karta me nocione.</p>	<p>Puna në grupe, nxit diskutime.</p> <p>Kërkoni prej nxënësve të propozojnë ide të tjera.</p> <p>Kjo mund të realizohet me gjithë klasën ose në çifte. Për disa karta mund të jenë të nevojshme ilustrime dhe fjalë.</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse(mjete dhe materiale)	Komente
	<p>Nxënësit bëjnë kalendarin vetë, për të treguar muajt e vitit, me ilustrime dhe ndodhi të rëndësishme për atë periudhë.</p> <p>Përgatitja e orarit për një javë me ilustrime dhe data të rëndësishme (ditëlindje, kalim në shkollë tjetër...).</p>		
<p>Zgjidhja e problemeve</p> <p>Zgjedh dhe përdor strategji mentale përkatëse për llogaritje dhe sqaron mënyrën si ka arritur deri tek përgjigjja.</p> <p>Gojarisht bën sqarimin e zgjidhjes dhe të menduarit.</p> <p>E përdor diturinë për zgjidhjen e problemeve.</p> <p>I kupton detyrat e thjeshta tekstuale(në një ose në dy hapa të lehta), përcakton cilat operacione janë të shfrytëzuar (mbledhje ose</p>	<p>Të hulumtohen mënyra të ndryshme për harxhimin e një shume të parave.</p> <p>Unë jam 10 cm më i lartë se motra ime, nëna ime është më e ulët 10 cm se motra ime. Unë jam e gjatë 130 cm. Sa janë të gjatë vëllai im dhe motra ime? Si e dinit këtë? Si e zgjodhët?</p> <p>Keni 95 litra ujë. Sa kova prej 10 l do të mbushni? Çfarë nëse ishin kovat prej 5/6/8 l? Shkova në shitore në orën 8 dhe u ktheva më 12.45 min. Sa kam qëndruar në shitore?</p> <p>Me zbatimin e veprimtarive të hapura nxënësit mund të sjellin vendime të veta, për shembull: loja në role.</p>	<p>Para të vërteta.</p> <p>Vizore, shirita për matje(metro)</p> <p>Enë që përmbajnë njësi matëse Litër. Orë digjitale dhe analoge.</p>	<p>Kërkoni disa nga nxënësit të parashtrajnë detyra dhe pyetje për nxënësit e tjerë të klasës. Kjo mund të përpunohet si detyrë shtëpie, në çifte ose në grupe...</p>

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurse(mjete dhe materiale)	Komente
<p>zbritje, shumëzimi ose pjesëtimi i thjeshtë)për zgjedhjen e tyre dhe me ndihmë, i prezanton me mjete, me vizatime dhe varg numrash.</p> <p>Paramendon ndodhi për detyrë të dhënë duke përfshirë në atë kontekst edhe para.</p> <p>Kontrollon përgjigjen e pyetjes me mbledhje në mënyra të ndryshme dhe përdor strategji të ndryshme si për shem.35+19 me mbledhje të 35 dhe 20 dhe zbret 1,dhe me mbledhje të 30+10 dhe 5+9.</p> <p>E kontrollon zbritjen me përdorim të mbledhjes. Bën vlerësim të arsyeshëm (të drejtë) për përgjigjen e një detyre.</p> <p>Jep mendim personal për ndonjë nga përgjigjet, a është e arsyeshme.</p>	<p>Me përdorimin e lojës në role, nxënësit krijojnë tregime personale për blerje ose fluturim dhe i shënojnë në mënyrë të vet.</p> <p>Përdorimi i diturive gjatë lojës në role.</p> <p>Të zbatuarit të diturive gjatë lojës në role.</p> <p>Loja në role.</p> <p>Loja në role.</p>		

3. Vlerësimi i të arriturave të nxënësve

KONTROLLI DIAGNOSTIK DHE VLERËSIMI

Në fillim të vitit shkollor mësuesi bën kontrollin diagnostik për të konstatuar zhvillimin dhe nevojat individuale të çdo nxënësi në funksion të planifikimit cilësor për realizimin e veprimtarive të ardhshme. Me anë të këtij kontrolli konstatohet shkalla e njohurive paraprake, niveli i socilaizimit, zhvillimi emocional dhe fizik.

VLERËSIMI FORMATIV – Gjatë zhvillimit të mësimit të lëndës së matematikës në klasën e parë udhëzohet përcjellje formative cila përfshin përpunim dhe mbajtjen e fakteve të nxënësve ku përfshihen:

- mbledhja e treguesve (punime të nxënësve, krijimeve të ndryshme, etj.) për secilin nxënësi;
- lista vlerësimi të vazhdueshëm (formativ) të përgatitura prej më parë të cilat plotëson pas ndonjë aktiviteti konkret specifik (pozitiv ose negativ) ose raste studimi në të cilat arsimtari shënon gjendjen faktike të nxënësit;
- Instrumentet që kanë të bëjnë me secilën fushë programore ku mësuesi evidenton, shënon të dhënat për të arriturat e nxënësit në të gjitha aspektet zhvillimore (kognitive - intelektuale, socio - emocionale, sociale dhe psikomotore). Listat e vlerësimit në radhë të parë duhet të përfshinë objektivat (qëllimet) të cilat duhet të arrihen kur e kryen klasën e dytë dhe nuk janë kaluese për klasën më të lartë.

VLERËSIMI MIKROSUMATIV

Në fund të tremujorit të dytë, në bazë të të dhënave të grumbulluara, nëpërmjet vlerësimit formative bëhet vlerësimi mikrosumativ.

VLERËSIMI SUMATIV

Duke u mbështetur në të dhënat e përgjithshme, të përfituara nga përcjellja dhe vlerësimi formativ, mësuesi e konstaton (përshkruan shkallën e zhvillimit dhe të arriturave të çdo nxënësi veçmas për çdo fushë programore.

QASJE DHE KOORDINIM ME PRINDËRIT PËR PËRMBLEDHJEN E DËSHMIVE

Gjatë gjithë vitit shkollor prindërit duhet të kenë qasje në përmbledhjen e dëshmimeve (portofolin) të fëmijës së tyre, që të mund të japin ndihmesën e tyre lidhur me realizimin më cilësor të mësimit të matematikës.

Nota përfundimtare analitike - përshkruese i jepet gjithashtu prindërve dhe bëhet pjesë përbërëse në përmbledhjen e dëshmimeve të nxënësit.

Të dhënat e përmbledhura të nxënësit të përzgjedhura dhe me të dhënat konkrete lidhur me të arriturat dhe vështirësitë e nxënësit përcillet më tej në klasat më të larta.

MËNYRAT PËR KONTROLLIM DHE VLERËSIM - Në përputhje me natyrën e programit të matematikës për klasën e dytë, kontrollimi dhe vlerësimi, duhet të bëhen me *gojë, në mënyrë praktike, me anë të prezantimeve, ushtrimeve dhe veprimtarive përkatëse.*

4. Kushtet hapësinore për realizimin e programit mësimor

Programi sa i përket kushteve hapësinore për realizimin e tij, bazohet në Normativin për hapësirën e klasës së I, II dhe III dhe mjeteve mësimore të sjella nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Normativi për kuadrin arsimor

Mësimin për lëndën e matematikës në klasë të dytë mund ta realizojë:

- Profesor për mësim klasor;
- Pedagog i diplomuar.

Nënshkrimi dhe data e verifikimit të programit mësimor

Programi mësimor për lëndën Matematika për klasë të dytë, në arsimin fillor nëntëvjeçar, e marrë dhe e lejuar nga Qendra ndërkombëtare për programe mësimore (Cambridge International Examination) dhe e adoptuar nga ana e Byrosë së zhvillimit të arsimit, e verifikuar

më datë

Ministër

Spiro Ristovski